



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:165552

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05784609

KE.nr. 978/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “ALPOR” Sh.P.K., me seli në Ferizaj, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Heset Agushi nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGMA” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit, jashtë seancës me datë 05.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e ushtruar nga paditësi ALPOR” Sh.P.K., kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “SIGMA” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit.

A r s y e t i m

Paditësi “ALPOR” Sh.P.K., përmes të autorizuarit të tij, me datë 02.08.2023 ka paraqitur padi kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve “SIGMA” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit.

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me parashtrësën e datës 04.06.2024 e ka njoftuar Gjykatën se për këtë çështje juridike e tërheqë padinë e parashtruar me datë 02.08.2023, për arsye se me të paditurit kanë arritur një pajtim jashtëgjyqësor.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës së përfaqësuesit të paditësit, në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) dhe nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:165552  
Datë: 05.06.2024  
Numri i dokumentit: 05784609

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 978/23, datë 05.06.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.